

Haradinaj paralajmëron
Kurtin: Rruga e vetmja
zgjidhje për ta kthyer në
binarë Kosovën. Shtatori po
vjen, Albin I FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

DEKLARATA E ZELENSKYT NË BEOGRAD PËR KOSOVËN NXIT REAGIME NË PRISHTINË, TIRANË DHE UKRAINË I FAQE 4-5



Deklarata e presidentit ukrainas, Volodymyr Zelensky, në Beograd se Ukraina vazhdon ta trajtojë Kosovën në kuadër të integritetit territorial të Serbisë ka shkaktuar reagime të forta në Prishtinë, Tiranë

dhe Ukrainë. Zyrtarë dhe politikanë kanë kundërshtuar qëndrimin e Zelenskyt, duke theksuar se pavarësia e Kosovës është rezultat i një procesi të veçantë politik dhe ndërkombëtar. Ata kanë vlerësuar

gjithashtu se çdo përpjekje për ta barazuar Kosovën me situatën në Ukrainë apo për ta përdorur rastin e Kosovës si precedent për agresionin rus është historikisht dhe juridikisht e pabazë

AKTUALE



**HAXHIU: DEKLARATAT E VUÇIOT
PËR NDRYSHIMIN E RRJEDHËS SË
IBRIT JANË KËRCËNUESË F. 5**

**KFOR-i NIS TRANZICIONIN GRADUAL
NË KOSOVË, INTEGROU POLICINË
NË SIGURINË E MANASTIRIT
TË DEÇANIT DHE LARGOHE
NGA URA E IBRIT F. 3**

**ANTERO LOPES MERR DETYRËN SI
SHEF I EULEX-IT NË KOSOVË F. 7**

EKONOMI



KOSOVA, E VARUR NGA IMPORTET F. 8

**RAFUNA: RITJA E ÇMMIT
TË NAFTËS PO UA RIT
KOSTOT BIZNESEVE, MUND
TË TKURRË PRODHIMIN DHE
TË RRIË PAPANËSINË F. 8**

SPORT



**FFK-ja ORGANIZON KURSIN
E PARË PËR TRAJNERË
PËR UEFA PRO LICENCË F. 10**

**SERBIA MBETET
BURIM KËRCËNIMI
PËR RAJONIN,
QËNDRIMET TOLERANTE
TË BE-SË E KANË**



**KONJUFCA
DHE GRUDA
PËRPLASEN NGA
DISTANCA PËR
MOSKONSTITUIMIN
E KUVENDIT F. 3**



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË



**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Amerika u kërkon prodhuesve të armëve të rrisin prodhimin, shqetësim për rezervat

UASHINGTON, 10 GUSHT - Departamenti Amerikan i Mbrojtjes u ka kërkuar kompanive të industrisë së mbrojtjes që të përshpejtojnë prodhimin e armëve, në një kohë kur janë duke u rritur shqetësimet se rezervat amerikane po pakësohen, ndërsa lufta në Iran është duke vazhduar. Në një memorandum të hartuar nga zëvendëssekretari

i Mbrojtjes, Steve Feinberg, kompanive u është dhënë një afat prej 21 ditësh për të paraqitur plane konkrete për rritjen e prodhimit dhe përshpejtimin e dorëzimit të pajisjeve dhe armëve kritike. Memorandumi synon që kompanitë të propozojnë afate dukshëm më të shpejta të furnizimit dhe rritje të kapaciteteve prodhuese.

Zëdhënësi i Pentagonit, Sean Parnell, ka konfirmuar se memorandum i është i vërtetë dhe është shprehur se ai do të merret në konsideratë gjatë përgatitjes së buxhetit për vitin fiskal 2028. Ndërkohë, buxheti për vitin 2027, i cili aktualisht është duke u shqyrtuar nga Kongresi, mund ta përshpejtojë këtë proces.

Parnell e ka mbrojtur nismën,

duke u shprehur se komunikimi i drejtpërdrejtë me drejtuesit e industrisë së mbrojtjes nuk është diçka e re për Pentagonin, raporton “CNN”. Sipas tij, Feinberg është duke udhëhequr përpjekjet për reformimin e sistemit amerikan të prokurimit të mbrojtjes dhe për rritjen e kapacitetit të prodhimit të armëve, në përputhje me nevojat dhe kërcënimet aktuale.



NETANYAHU REFUZON PLANIN E TRUMPIT PËR GAZËN: IZRAELI S’I TËRHEQË TRUPAT PA ÇARMATIMIN E HAMASIT

JERUSALEM, 10 GUSHT - Kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu ka refuzuar planin prej 15 pikash të presidentit amerikan, Donald Trump për Gazën, duke deklaruar se Izraeli nuk do t’i tërheqë trupat e tij nga territori, për sa kohë Hamasi nuk është çarmatosur plotësisht dhe në mënyrë të verifikueshme. Bordi i Paqes, një organ i krijuar me nismën e presidentit Trump, ka njoftuar muajin e kaluar se kishte arritur një marrëveshje për “çarmatimin e plotë” të Hamasit dhe grupeve të tjera të armatosura në Gaza. Por, Hamasi ka deklaruar se dorëzimi i armëve të rënda mund të bëhet vetëm nëse Izraeli i jep fund “të gjitha



formave të agresionit” dhe i tërheq forcat e tij nga Gaza. Ndërkohë, ushtria izraelite është duke vijuar sulmet në Gaza edhe pas marrëveshjes për armëpushimin fillestar, të arritur tetorin e kaluar. “Izraeli e refuzon dokumentin prej 15 pikash”,

është shprehur Netanyahu gjatë një mbledhjeje të kabinetit të tij. Ai ka deklaruar se ushtria izraelite nuk do t’i tërheqë trupat e saj nga Rripi i Gazës derisa Hamasi të çarmatoset plotësisht. Netanyahu është shprehur se forcat izraelite do të vazhdojnë të

neutralizojnë çdo kërcënim ndaj trupave dhe qytetarëve të Izraelit. Muajin e kaluar, Trumpi e ka cilësuar pranimin e planit të çarmatimit nga Hamasi si një “hap monumental drejt paqes dhe sigurisë afatgjatë”. Netanyahu ka këmbëngulur se Hamasi duhet të çarmatoset përpara çdo tërheqjeje izraelite nga Gaza. Ai ka theksuar se nuk mund të bëhet fjalë për një “çarmatim fiktiv”. Netanyahu është shprehur se tashmë kanë nisur diskutimet me zyrtarët amerikanë për mënyrën se si duhet të vijojë procesi. “Ata kanë ide. Disa prej tyre janë të pranueshme për ne dhe disa jo. Ne dimë si të qëndrojmë të vendosur për këto çështje”,

është shprehur kryeministri izraelit. Netanyahu përballet gjithashtu me presion të fortë nga aleatët e tij të ekstremit të djathtë, të cilët kërkojnë një votim të ri në kabinet dhe anulimin e planit për Gazën. Ministri i Sigurisë Kombëtare e ka cilësuar draftin si “të papranueshëm”. Refuzimi i Netanyahut përbën një tjetër goditje për planin e paqes të Donald Trumpit për Gazën, i cili është prezantuar në shtator të vitit të kaluar. Plan i parashikon krijimin e një Bordi të Paqes për të mbikëqyrur zbatimin e marrëveshjes, çarmatimin e Hamasit, tërheqjen e trupave izraelite nga Gaza dhe rindërtimin e territorit.

ÇMIMET E NAFTËS RRITEN LEHTË, NDËRSA RIHAPJA E NGUSHTICËS SË HORMUZIT DUKET E LARGËT

TEHERAN, 10 GUSHT - Çmimet e naftës janë duke mbetur të larta pasi Irani është shprehur se një marrëveshje e afërt me Omanin për menaxhimin e ngushticës së Hormuzit nuk do të mjaftonte për rihapjen e kësaj rruge ujore jetike. Teherani ka kërkuar gjithashtu që Shtetet e Bashkuara të përmbushin një sërë kushtesh. Nafta “Brent”, standardi global i naftës, është rritur me 0.6 për qind, në 84.03 dollarë për fuçi.

“WTI”, standardi amerikan, është rritur lehtë me 0.4 për qind, në 78.49 dollarë për fuçi. Irani ka kërkuar nga ShBA-ja t’i ndalojë sulmet dhe t’i japë fund bllokadës ndaj porteve iraniane, si dhe të heqë sanksionet, të zhbllokojë asetet iraniane dhe të paguajë kompensim për dëmet e shkaktuara nga lufta. Lista e kërkesave nuk ndryshon në mënyrë thelbësore nga ato të paraqitura në memorandumin e mirëkuptimit, të cilin ShBA-ja



dhe Irani e kanë nënshkruar në qershor. Por toni sugjeron se Teherani mund të jetë duke mbajtur një qëndrim më të ashpër, gjë që mund të vonojë më tej rikthimin e plotë të kalimit

të anijeve përmes ngushticës së Hormuzit, nëpër të cilën kalonte një e pesta e furnizimit global me naftë para luftës. Në të njëjtën kohë, eksportet e naftës së Arabisë Saudite përmes Detit të Kuq dhe ngushticës Bab el-Mandeb janë duke u kërcënuar nga sulmet e grupit të milicisë Huthi, të mbështetur nga Irani, ndaj anijeve në këtë korridor detar, i cili është bërë një alternativë thelbësore ndaj Hormuzit. Rebelët Huthi

gjithashtu kanë shënjestruar një rafineri të madhe saudite të naftës në bregdetin e Detit të Kuq të dielën. Çmimet e naftës kanë qenë shumë të paqëndrueshme javët e fundit, mes marrëveshjeve që herë avancojnë e herë dështojnë për rihapjen e ngushticës. Në fillim të korrikut, nafta “Brent” ka rënë në nivelet e fundit të regjistruara para luftës, pranë 70 dollarëve për fuçi, për t’u rikthyer vetëm disa javë më vonë mbi 100 dollarë për fuçi.

“Armiku” i Orbanit mund të bëhet sot president i Hungarisë

BUDAPEST, 10 GUSHT - Një emër i njohur për përplasjet me qeverinë e Viktor Orbanit mund të rikthehet në qendër të politikës hungareze, këtë herë si kreu i shtetit. Andras Baka, ish-kryetar i Gjykatës së Lartë të Hungarisë, është kandidati i propozuar nga partia në pushtet Tisza për postin e presidentit. Zgjedhja e tij pritet të hidhet sot (e martë), në votim në Parlament. Baka ka një histori të

drejtpërdrejtë përplasjeje me qeverinë e Viktor Orbanit. Në vitin 2011, ai është larguar nga posti i kryetarit të Gjykatës së Lartë, tre vjet para përfundimit të mandatit. Çështja ka shkuar deri në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Në vitin 2014, gjykata në Strasburg ka arritur në përfundimin se shkarkimi i Bakës ka qenë i lidhur me kritikën e tij ndaj qeverisë dhe se mënyra e largimit të tij ka cenuar

parimet demokratike. Qeveria hungareze i ka mohuar këto akuza. Partia Tisza, e drejtuar nga kryeministri Peter Magyar, e konsideron Bakën një mbështetës të fortë të shtetit të së drejtës, pavarësisë së gjyqësorit dhe ndarjes së pushteteve. Kandidatura e tij vjen në një moment kur qeveria e re synon të ndryshojë sistemin politik të ndërtuar gjatë 16 viteve të qeverisjes së Viktor Orbanit. Pas fitores në zgjedhjet e

prillit, Peter Magyar ka nisur përpjekjet për të larguar nga institucionet zyrtarët e emëruar gjatë qeverisjes së mëparshme. Megjithatë, presidenca hungareze nuk ka kompetenca të gjera politike. Sipas Kushtetutës, presidenti ka kryesisht një rol ceremonial, ndërsa mund të kthejë ligjet për rishqyrtim ose të pengojë përkohësisht hyrjen e tyre në fuqi. Ndërkohë, opozita hungareze ka deklaruar se nuk do të



marrë pjesë në procesin parlamentar për zgjedhjen e presidentit. Partia e Viktor Orbanit e akuzon qeverinë e re për ndjekje të politikave autoritare, akuza që Tisza i ka kundërshtuar.

Dehari: Pa marrëveshje politike pashmangshëm shkojmë në zgjedhje të reja

PRISHTINË, 10 GUSHT - Kryesuesi i seancës konstituive të Kuvendit të Kosovës, Avni Dehari, është shprehur se pa një marrëveshje politike për konstituimin e institucioneve, vendi pashmangshëm do të shkojë në zgjedhje të reja, të cilat i ka cilësuar të panevojshme dhe të dëmshme. Dehari ka theksuar se marrëveshja politike duhet të arrihet, duke shtuar se një gjë të tillë, sipas tij, e kërkojnë Kushtetuta dhe Gjykata Kushtetuese. “Pa marrëveshje politike pashmangshëm shkojmë në zgjedhje të reja, të përsëritura,

të panevojshme, të dëmshme. Duhet të arrihet marrëveshja politike. Këtë e kërkon Kushtetuta e Republikës dhe Gjykata Kushtetuese, këtë e pret populli i Kosovës dhe e ardhmja jonë”, ka shkruar Avni Dehari në “Facebook”. Ai ka drejtuar akuza edhe ndaj një pjese të deputetëve opozitarë, duke pretenduar se disa prej tyre nuk duan marrëveshje për konstituimin e institucioneve dhe synojnë incidente në seancën konstituive. “Ka jo pak deputetë opozitarë që nuk duan kurrfarë marrëveshje politike për

konstituim të institucioneve dhe që duan incidente fizike në seancën konstituive”, është shprehur Dehari. Ndërsa kryeministri në detyrë dhe lideri i LV-s, Albin Kurti, është shprehur të hënën se bisedimet për arritjen e një marrëveshjeje politike do të vazhdojnë, me qëllim shmangien e zgjedhjeve të reja. Kurti ka bërë me dije se është në komunikim me liderët politikë dhe se synimi është arritja e një marrëveshjeje që do t'i hapte rrugë zgjidhjes së ngërçit institucional. Të shtunën është ndërprerë sërish vazhdimi i



seancës konstituive. Kjo pasi Kurti, ka kërkuar kohë shtesë për propozimin e kandidatit për kryetar të Kuvendit. Ai ka deklaruar se kjo kërkesë vjen pasi ende nuk ka marrëveshje politike. “Takimet dhe komunikimi im, si kryeministër në detyrë dhe

kryetar i subjektit fitues Lëvizja Vetëvendosje, me kryetarët e partive të tjera parlamentare, kanë vazhduar. Marrëveshje politike nuk kemi ende, prandaj që t'i evitojmë zgjedhjet e reja, lus për kohë shtesë”, ka thënë Kurti. Pas kësaj kërkesë, deputetja e Aleancës, Time Kadrijaj, ka sulmuar me vezë kryetarin e LV-së, Albin Kurtin. Për shkak të këtij incidenti, kryesuesi Dehari ka kërkuar që sigurimi i Kuvendit të hyjë në sallë. Në zgjedhjet e 7 qershorit, LV-ja ka marrë 53 deputetë, PDK-ja 22, LDK-ja 18, ndërsa Aleanca 7.

KONJUFCA DHE GRUDA PËRPLASEN NGA DISTANCA PËR MOSKONSTITUIMIN E KUVENDIT

PRISHTINË, 10 GUSHT - Ministri në detyrë i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Glauk Konjufca, është shprehur se nuk beson se procesi aktual i konstituimit të Kuvendit është duke u zhvilluar në kundërshtim me Kushtetutën. Sipas tij, themelimi i Kuvendit mund të zgjasë më shumë se një ditë, ndërsa sa i përket çështjes së afatit prej 24 orësh për përfundimin e seancës konstituive, është shprehur se ekzistojnë interpretime të ndryshme nga ekspertët kushtetues. “Ne nuk mendojmë që është shkelur Kushtetuta. Për shkak të këtyre momenteve dhe proceseve, prej zgjedhjeve të shkurtit ka qenë duke u interpretuar. I patëm disa momente edhe vitin e kaluar kur ishin të paqarta. Diskutimi ka të bëjë me ditën e mbajtjes së seancës dhe a e përbën një entitet të vetëm dhe a duhet të përfundojë brenda 24 orëve mbajtja e seancës apo jo. Sipas disa ekspertëve, të cilët kanë interpretime të ndryshme, mund të zgjasë edhe më shumë se 24 orë. Kështu është duke ndodhur edhe tash, po zgjat më shumë se një ditë. Nuk është



dramatike qysh po e interpreton opozita, është pjesë e formësimit të mëtejshëm kushtetues të vendit tonë. Kur do të thirret seanca, nuk mund ta caktoj unë”, ka thënë Konjufca. Konjufca është shprehur se, sipas tij, konstituimi i Kuvendit mund të zgjasë më shumë se një ditë dhe se përpjekjet për dialog politik janë duke vazhduar. “Unë mendoj që konstituimi mund të zgjasë më shumë se një ditë. Kurti do t'u drejtohet sërish, kurrë nuk do të lodhemi nga dialogu politik, do të vazhdojnë përpjekjet edhe PDK-ja, edhe LDK-ja e Aleanca. Çdo dëm që ju

po e konsideroni është më i vogël se ajo çka pamë në seancë, dhuna ndaj kryeministrit dhe ndaj deputetëve tanë. A thonit keq edhe atëherë? Nëse është keq, është keq edhe kësaj radhe. Është më pak dëm sesa të shkohet në zgjedhje të reja, të dy këto dëme janë më të mëdha. Nuk është duke u shkelur Kushtetuta”, është shprehur Konjufca. Ndërsa ushtruesja e detyrës së presidentes, Albulena Haxhiu, ka thënë se kushdo që konsideron se është shkelur Kushtetuta, le t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese.

Gruda i kundërpërgjigjet Konjufcës: Gjykata Kushtetuese e ka përcaktuar qartë afatin për konstituimin e Kuvendit

Deputeti i zgjedhur i PDK-së, Përparim Gruda, është shprehur kundër deklaratës së kryetarit të Kuvendit, Glauk Konjufca, se vazhdimi i seancës konstituive nuk përbën shkelje kushtetuese.

Gruda ka theksuar se Gjykata Kushtetuese interpreton Kushtetutën dhe jo aktgjykimet e saj. “Glauk Konjufca, në Gjykatën Kushtetuese shkohet për të interpretuar Kushtetutën, jo për të interpretuar aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese, sepse kjo do të ishte të kërkoje interpretim mbi interpretimin”, ka shkruar Gruda. Sipas tij, Gjykata Kushtetuese, në Aktgjykimin KO124/25, e ka përcaktuar qartë se Kuvendi duhet ta përfundojë konstituimin brenda 30 ditësh nga certifikimi i rezultateve të



zgjedhjeve. “Gjykata, në Aktgjykimin KO124/25, e ka përcaktuar qartë se brenda 30 ditëve nga data e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, Kuvendi duhet ta përfundojë konstituimin, e jo vetëm ta fillojë atë, siç po pretendon ti”, ka deklaruar ai. Gruda i është referuar edhe paragrafit 140 të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese. “Lexoje çfarë thotë paragrafi 140: ‘(...) Gjykata vlerëson se afati 30 (tridhjetë) ditor i përcaktuar nga kushtetutbërësi në paragrafin 1 të nenit 66, nuk mund të trajtohet si afat brenda të cilit vetëm duhet provuar konstituimi i Kuvendit, porse ky afat (...) është afat brenda të cilit duhet të konstituohet Kuvendi’”. Në fund, Gruda ka ngritur pyetjen se çfarë do të kërkohej nga Gjykata Kushtetuese nëse çështja do të dërgohej sërish për interpretim. “Pra, kjo çështje është interpretuar një herë nga Gjykata Kushtetuese dhe është interpretuar qartë. Çfarë po kërkon të dërgojmë edhe një herë në gjykatë? Që gjykata ta interpretojë interpretimin e vet?”, ka përfunduar Gruda.

Mërgimtarët në Kuvend: Bllokada është skandaloze, duam shtet që të krenohet Evropa

PRISHTINË, 10 GUSHT - Mërgimtarët që kanë vizituar të hënën Kuvendin e Kosovës e kanë cilësuar si “skandaloze” bllokadën institucionale në vend, duke u shprehur se Kosova duhet të ketë një shtet për të cilin do të krenohet e gjithë Evropa. Kuvendi i Kosovës ka hapur dyert për bashkatdhetarët për tri ditë radhazi, duke u mundësuar atyre të njihen nga afër me hapësirat dhe punën e këtij institucioni. Në kuadër të kësaj vizite, ushtruesja e detyrës së presidentes së Kosovës dhe kryeparlamentarja Albulena Haxhiu, ka pritur në Kuvend bashkatdhetarët që po

qëndrojnë në Kosovë gjatë sezonit të verës. Selatin Tahiri nga Gjermania, i cili prej 35 vitesh jeton në këtë shtet, është shprehur se vizita në Kuvend është një ndjenjë e veçantë, ndërsa ka komentuar edhe situatën politike në vend. “Me qëndrim në Gjermani, mirëpo jam nga Prishtina. Përndryshe, i lindur në fshatin Koliq. Që 35 vite në Gjermani. Kosovën e vizitoj çdo vit. Familjarët, mirëpo edhe takimet e shpeshta me përfaqësues, me politikanë, me delegatë të parlamentit. Kjo është ndjenjë e veçantë. Është Parlamenti i Kosovës, është një objekt ku merren ligje, ku shteti funksionon përmes parlamentit, përmes ligjeve, përmes kësaj



strukture politike. Bllokada është shumë, nuk di si ta quaj, nëse e quaj skandaloze. Nuk ka pasur nevojë, e panevojshme të bëhet një bllokadë e tillë, kur të gjithë jemi shqiptarë, të kuptojmë të mirën e vetvetes dhe ta kemi një shtet të cilin do të krenohet e gjithë Evropa, të gjitha vendet e tjera. Po ndodhi kjo që ndodhi”, është shprehur ai. Një tjetër mërgimtar, i cili me

vete kishte marrë edhe vajzën nga Gjermania, është shprehur se vizita në Kuvend lidhet me të ardhmen e fëmijëve dhe gjeneratave të reja. “Është për shtetin tonë. Edhe unë e kapa procesin afër, e kapa edhe vajzën e vogël, se e ardhmja jonë. Edhe veçse që kanë me i rritë mbarë, për së pari për fëmijët tanë, gjeneratat tona të reja që vijnë, që ne me mund me i rritë me një rritje fort të gjerë këtu. Për partitë politike, unë jam idealist, por nuk jam militantist. Unë kam qenë në parti tjetër politike, sot jam në parti tjetër politike. Po për rrethanat e Lëvizjes Vetëvendosje, për atë e kam marrë edhe vajzën e vogël, se Vetëvendosja është e vetmja

parti politike sot që ka menduar për fëmijët, për fëmijët tanë që me lindë në një shtet që kujdeset dikush për ta”, ka thënë ai. Një tjetër mërgimtar nga Turqia është shprehur se kishte ardhur nga Ankara së bashku me fëmijët për të vizituar Kuvendin e Kosovës. “Ne erdhëm prej Turqisë, nga Ankara. Erdhëm, kemi pasur fëmijët këtu me vizituar Kuvendin e Kosovës. Po, është ky vend, është personalisht për vendin mjaft i rëndësishëm. Gjithmonë po vazhdon, inshallah gjithmonë me suksese. Shpresoj që do ta kalojnë. Është këtu gjithmonë me dialog, po vazhdojnë punët”, është shprehur ai.

SERBIA MBETET BURIM KËRCËNIMI PËR RAJONIN, QËNDRIMET TOLERANTE TË BE-së E KANË INKURAJUAR ATË

EPOKA E RE

Lirim GECI

PRISHTINË, 10 GUSHT - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka deklaruar se zgjerimi i kapaciteteve ushtarake të Serbisë është pjesë e një strategjie më të gjerë politike dhe diplomatike, e cila, sipas tij, lidhet me synimet hegjemoniste të Beogradit në rajon dhe veçanërisht ndaj Kosovës. “Zhvillimet gjeopolitike të kohës sonë, përfshirë ndikimin e Rusisë në Ballkanin Perëndimor, kanë rritur ndjeshmërinë e sigurisë në rajon. Zgjerimi i kapaciteteve ushtarake të Serbisë nuk është thjesht përpjekje për të modernizuar ushtrinë e saj, por një strategji më e gjerë politike dhe diplomatike, e cila lidhet drejtpërdrejt me synimet e saj hegjemoniste karshi rajonit tonë, e veçanërisht Kosovës”, ka theksuar Kurti në Konferencën e 9-të të Ambasadorëve të Republikës së Kosovës, e cila po mbahet në Prishtinë me temën “Kosova në një botë në ndryshim: Siguri, Partneritet dhe Zhvillim”.

Në fjalën e tij, Kurti ka thënë se mjedisi ndërkombëtar është bërë më kompleks dhe se roli i ambasadorëve nuk kufizohet më vetëm në marrëdhëniet tradicionale ndërmjet shteteve. “Angazhimi përtej marrëdhënieve tradicionale shtet me shtet imponon më shumë se sa përfaqësim formal. Ai kërkon punë të vazhdueshme për të krijuar kontakte, për të ndërtuar partneritete dhe për të hapur mundësi të reja për vendin”, është shprehur Kurti.

Ai ka folur edhe për ndryshimet në sigurinë globale, duke përmendur tensionet gjeopolitike, konkurrencën ndërmjet fuqive të mëdha, si dhe zhvillimet në fushën e inteligjencës artificiale dhe informatikës kuantike.

Sipas Kurtit, agresioni rus ndaj Ukrainës ka ndryshuar perceptimet për paqen dhe stabilitetin në Evropë. “Që nga koha e agresionit rus kundër Ukrainës, supozimet e dikurshme mbi paqen dhe stabilitetin, të ndërtuara pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, nuk qëndrojnë më. Përdorimi i forcës ushtarake, kapaciteteve kibernetike, fushatave dezinformuese dhe ndikimit politik të Rusisë te vendet e tjera kanë nxjerrë në sipërfaqe natyrën në zhvillim e sipër të konflikteve moderne. Përmes veprimeve të saj, Rusia ka demonstruar se këto konflikte zhvillohen përtej fushëbetejave, duke uzurpuar hapësirën digjitale dhe duke prodhuar forma të reja të kërcënimeve hibride”, ka deklaruar ai.

Kryeministri në detyrë ka theksuar gjithashtu rrezikun që paraqesin fushatat e dezinformimit dhe manipulimit të informacionit. “Manipulimi dhe ndërhyrja e huaj në informacion ndryshon edhe mënyrën e të bërit diplomaci. Diplomatat e ditëve të sotme

duhet të merren edhe me menaxhimin e informacionit, edhe me luftimin e dezinformimit, e edhe me ruajtjen e besimit nga publiku. Është tejte e rëndësishme që të identifikoni dhe t'i kundërshtoni narrativat e rreme. Kjo mund të bëhet më së miri duke u ofruar informacion të mbështetur në fakte për arritjet tona dhe duke u angazhuar me akterë të ndryshëm joshjetëror edhe në platformat digjitale në kohë reale”, ka thënë Kurti.

Duke folur për situatën në Ballkanin Perëndimor, Kurti ka thënë se ndikimi i Rusisë në rajon dhe zhvillimet në Serbi kanë rritur ndjeshmërinë e sigurisë.

Ai ka theksuar se retorika e liderëve serbë dëshmon vijimësinë e pretendimeve ekspansioniste të Serbisë në rajon.

Përballë këtyre zhvillimeve, Kurti ka thënë se Kosova është përcaktuar për forcimin e institucioneve demokratike, rritjen e kapaciteteve të sigurisë dhe thellimin e partneriteteve ndërkombëtare.

“Për Kosovën, kjo nënkupton vazhdimësinë e partneritetit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe aleatë të tjerë që ndajnë të njëjtat vlera dhe që mbeten të përkushtuar për të ruajtur një rend ndërkombëtar të bazuar në rregulla”, është shprehur Kurti.

Sipas tij, partneriteti me NATO-n dhe programet e bashkëpunimit dypalësh janë ndër shtyllat kryesore për konsolidimin e kapaciteteve të sigurisë së Kosovës. “Prania dhe roli i NATO-s në Kosovë dhe rajon mbeten faktor kyç për ruajtjen dhe garantimin e stabilitetit rajonit. Roli ynë diplomatik merr një rëndësi të veçantë në këtë periudhë, jo vetëm për të mbrojtur interesat tona kombëtare, por edhe për të prezantuar një Kosovë të zhvilluar e prosperuese, të besueshme dhe të gatshme të kontribuojë në paqen, sigurinë dhe zhvillimin e përbashkët rajonal, evropian e ndërkombëtar”, ka shtuar Kurti.

Ai ka përmendur edhe marrëveshjen trilaterale ushtarake me Shqipërinë dhe Kroacinë, marrëveshjet dypalëshe me ShBA-në, Turqinë, Mbretërinë e Bashkuar dhe shtete të tjera, si dhe misionet e përbashkëta me ushtritë e ShBA-së dhe Britanisë së Madhe në Kuvajt, Belize dhe Ishujt Falkland.

Konjufca: Serbia mbetet burim kërcënimi për rajonin, qëndrimet tolerante të BE-së e kanë inkurajuar

Ndërsa ministri në detyrë i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Glauk Konjufca, është shprehur se Serbia vazhdon të përbëjë kërcënim për paqen dhe stabilitetin në rajon. Ai ka kritikuar edhe qëndrimet e Bashkimit Evropian ndaj politikës së Beogradit.

Konjufca është shprehur se

retorika zyrtare e Serbisë ndaj Kosovës mbetet agresive. Ai ka përmendur edhe bashkëpunimin ushtarak të Beogradit me Kinën dhe qëndrimet e tij ndaj zhvillimeve ndërkombëtare. “Në të njëjtën kohë edhe ka intensifikuar bashkëpunimin ushtarak me vende si Kina, dhe është i vetmi vend i cili në rajon mori pjesë në ceremoninë mortore të ish-udhëheqësit iranien Khamenei. Ky orientim i Serbisë është më shumë sesa një pozicion i dyzuar në arenën ndërkombëtare. Retorika e pandryshuar agresore e politikës zyrtare serbe kundrejt Republikës së Kosovës dëshmon se Serbia është burim kërcënimi dhe destabiliteti për paqen rajonale dhe evropiane. Deklarata e ministres serbe se po të ishte në vend të Milosheviqit do ta spastronte etnikisht Kosovën sërisht, është një deklaratë që duhet ta marrim seriozisht jo vetëm si shtet i Kosovës, por duhet të merret po aq me vëmendje dhe me seriozitet edhe nga aleatët tanë ndërkombëtarë, që kanë investuar dhe investojnë në sigurinë dhe në paqen e rajonit tonë. Qëndrimet tolerante të Bashkimit Evropian ndaj pozicioneve të tilla të Serbisë e kanë inkurajuar vetë Serbinë”, është



shprehur ai. Duke folur për orientimin e politikës së jashtme të Kosovës, Konjufca është shprehur se vendi ka qëndruar në mbështetje të aleancës perëndimore dhe Ukrainës përballë agresionit rus. “Rrethanat e trazuara globale të viteve të fundit kanë dëshmuar se Republika e Kosovës, si shtet sovran, dhe i pavarur, ka qëndruar e palëkundur në mbështetjen e aleancës perëndimore për të mbrojtur sovranitetin dhe integritetin e Ukrainës kundrejt agresionit të Rusisë dhe i ka mbështetur të gjitha masat sanksionuese që aleanca perëndimore ia ka vendosur Federatës Ruse. Po ashtu, Republika e Kosovës qëndron përkrah aleatit

tonë më të madh, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në përpjekjen e tyre për të ndërtuar paqen në Lindjen e Mesme. Anëtarësimi në Bordin e Paqes i themeluar nga Presidenti Trump dhe dërgimi i ushtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Gaza në kuadër të Trupës Paqeruajtëse janë dëshmi e orientimit dhe e lojalitetit tonë ndaj këtij partneriteti, që e kemi”, është shprehur ai.

Konjufca është shprehur se Konferenca e Ambasadorëve është një aktivitet i rregullt vjetor, përmes të cilit shqyrtohen rezultatet e diplomacisë së Kosovës dhe diskutohen zhvillimet ndërkombëtare që prekin interesat e vendit.

HAXHIU: DEKLARATAT E VUÇIQIT PËR NDRYSHIMIN E RRJEDHËS SË IBRIT JANË KËRCËNUESE

Prishtinë, 10 gusht - Ushtruesja e detyrës së presidentes së Kosovës, Albulena Haxhiu, është shprehur se deklaratat e fundit të presidentit serb, Aleksandër Vuçiq, për mundësinë e ndryshimit të rrjedhës së lumit Ibër paraqesin shqetësim serioz për Kosovën dhe duhet të adresohen me partnerët ndërkombëtarë.

Haxhiu, në edicionin e nëntë të Konferencës së Ambasadorëve, organizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, u ka kërkuar diplomatëve të Kosovës që t'i informojnë qeveritë e vendeve ku shërbejnë për pasojat që, sipas saj, mund të ketë një ndërhyrje në rrjedhat ujore ndërkufitare.

Ajo ka theksuar rëndësinë e sistemit Ibër-Lepenc dhe të liqenit të Ujmanit për furnizimin me ujë, energjinë, bujqësinë dhe jetën e qytetarëve të Kosovës.

“Nga ana tjetër, Serbia vazhdon politikën e saj hegjemoniste ndaj Kosovës. Një tjetër shqetësim serioz që duhet të adresohet me partnerët tanë ndërkombëtarë janë edhe deklaratat e fundit të Vuçiqit për mundësinë e ndryshimit të rrjedhës së lumit Ibër. Siç e dini,



Ibër-Lepenci dhe liqeni i Ujmanit janë pjesë e një sistemi esencial për furnizim me ujë, për energjinë, bujqësinë dhe jetën e qindra mijëra qytetarëve të Kosovës. Ndërhyrja e njëanshme në rrjedhat ujore ndërkufitare do të kishte pasoja shumë përtej një çështjeje teknike. Ajo do të prekte sigurinë ujore, energjetike, mjedisore dhe njerëzore të Republikës sonë”, është shprehur ajo. Haxhiu ka kërkuar që diplomatët kosovarë t'i bëjnë të njohura këto deklaratat në kryeqytetet ku shërbejnë dhe t'i informojnë qeveritë e vendeve

pritëse për natyrën dhe pasojat e kësaj ideje, absurde sa edhe kërcënuese. Duhet ta bëjmë të qartë se përdorimi i burimeve ujore si instrument presioni ndaj Kosovës është i papranueshëm dhe se ide të tilla që ringjallin qasje shoviniste dhe destabilizuese ndaj Kosovës duhet të marrin vëmendjen dhe reagimin e duhur ndërkombëtar”, ka theksuar Haxhiu.

Ajo ka shtuar se Kosova pret nga partnerët ndërkombëtarë që çdo veprim që rrezikon burimet ujore jetike të vendit të trajtohet në përputhje me parimet e së drejtës ndërkombëtare për ujërat ndërkufitare.

Ndërsa duke folur për raportet me Serbinë, Haxhiu ka deklaruar se Beogradi duhet të mbajë përgjegjësi për sulmin terrorist në Banjskë, sulmet ndaj pjesëtarëve të KFOR-it, gazetarëve dhe qytetarëve, si dhe për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur gjatë luftës.

Ajo ka përmendur edhe zhvillimet e fundit në Zubin Potok, ku janë gjetur mbetje mortore që dyshohet se u përkasin viktimave të luftës së viteve 1998-1999, duke kërkuar nga Serbia hapjen e arkivave.

DEKLARATA E ZELENSKYT NË BEOGRAD PËR KOSOVËN NXIT REAGIME NË PRISHTINË, TIRANË DHE UKRAINË

Deklarata e presidentit ukrainas, Volodymyr Zelensky, në Beograd se Ukraina vazhdon ta trajtojë Kosovën në kuadër të integritetit territorial të Serbisë ka shkaktuar reagime të forta në Prishtinë, Tiranë dhe Ukrainë. Zyrtarë dhe politikanë kanë kundërshtuar qëndrimin e Zelenskyt, duke theksuar se pavarësia e Kosovës është rezultat i një procesi të veçantë politik dhe ndërkombëtar. Ata kanë vlerësuar gjithashtu se çdo përpjekje për ta barazuar Kosovën me situatën në Ukrainë apo për ta përdorur rastin e Kosovës si precedent për agresionin rus është historikisht dhe juridikisht e pabazë.

PRISHTINË, 10 GUSHT - Deklarata e presidentit ukrainas, Volodymyr Zelensky, se Kiev vazhdon ta trajtojë Kosovën në kuadër të integritetit territorial të Serbisë, ka nxitur reagime në Prishtinë dhe Tiranë, ndërsa një deputet ukrainas e ka cilësuar qëndrimin e tij “gabim diplomatik” dhe ka kërkuar njohjen e Kosovës nga Ukraina.

Gjatë vizitës së parë zyrtare në Beograd, Zelensky është shprehur se shteti i tij s'ka ndryshuar qëndrim sa i përket mosnjohjes së Kosovës dhe ka thënë se respekton integritetin territorial të Serbisë dhe të drejtën ndërkombëtare. Udhëheqësi ukrainas ka thënë se shteti i tij i është mirënjohës Serbisë për respektimin e integritetit territorial të Ukrainës, përfshirë Krimeën – të cilën Rusia e ka aneksuar paligjshëm më 2014. Megjithatë, qëndrimi i Zelenskyt nuk mbështetet nga të gjithë politikanët ukrainas.

Oleksiy Goncharenko, deputet i Parlamentit ukrainas nga partia opozitare Solidariteti Evropian dhe përfaqësues i Ukrainës në Asambleen Parlamentare të Këshillit të Evropës, e ka cilësuar atë si “gabim diplomatik”, duke u shprehur se Ukraina duhet ta njohë pavarësinë e Kosovës. “Ukrainasit e mbështesin pavarësinë e Kosovës dhe ne besojmë se Ukraina duhet ta njohë shtetin”, ka shkruar Goncharenko në “X”, duke shtuar se do të vazhdojë të angazhohet për njohjen e Kosovës dhe se beson se Kiev përfundimisht do ta marrë një vendim të tillë.

Ndaj deklaratës së Zelenskyt ka reaguar edhe Yuriy Hudymenko, veteran ukrainas i luftës dhe kryetar i Këshillit Publik Kundër Korrupsionit pranë Ministrisë së Mbrojtjes së Ukrainës. Në një postim në “Facebook”, ai është shprehur se ndihet “i neveritur dhe i turpëruar” nga qëndrimi i presidentit ukrainas, duke kujtuar mbështetjen që Kosova u ka dhënë ukrainasve, ushtarëve dhe refugjatëve që nga nisja e pushtimit rus. “Shpresoj që miqtë e mi nga Kosova ta kuptojnë se fjalët e presidentit nuk janë gjithmonë mendimi i të gjithë vendit”, ka shkruar Hudymenko. “Radio Evropa e Lirë” i është drejtuar ekipit për media të presidentit ukrainas, Volodymyr Zelensky, për sqarime shtesë lidhur me deklaratat e tij për Kosovën dhe është në pritje të përgjigjes.

Konjufca: Kosova do ta mirëpriste njohjen nga Ukraina

Ministri në detyrë i Punëve të Jashtme dhe Diasporës të Kosovës, Glauk Konjufca, ka shprehur keqardhje për deklaratën e Zelenskyt dhe ka kundërshtuar paraqitjen e Kosovës përmes prizmit të integritetit territorial të Serbisë. “Kosova mbetet e palëkundur në mbështetjen e saj për sovranitetin, pavarësinë dhe integritetin territorial të Ukrainës. Në të njëjtën kohë, ne e kundërshtojmë në mënyrë të vendosur çdo paraqitje të Republikës së Kosovës përmes prizmit të integritetit territorial të Serbisë”, është shprehur Konjufca në reagimin e tij në “X”. Konjufca po ashtu është shprehur se Kosova do të mirëpriste njohjen nga Ukraina, duke argumentuar se një vendim i tillë do të forconte parimet e lirisë, demokracisë dhe ligjit ndërkombëtar që “Ukraina po i mbron sot”.

Konjufca ka thënë se shteti i Kosovës lindi nga lufta e popullit për liri dhe çlirimi i tyre më 1999 erdhi pas “vite të shtypjes sistematike dhe fushatës gjenocidale të regjimit të Millosheviqit”. “Ajo që pasoi nuk ishte një akt aneksimi, okupimi apo pushtimi territorial, por një proces gjithëpërfshirës ndërkombëtar nën administratën e Kombeve të Bashkuara dhe ndërmjetësimit ndërkombëtar për statusin final të Kosovës”, është shprehur Konjufca.

Ai ka thënë se, kur negociatat përfunduan, i dërguari i posaçëm i OKB-së, Martti Ahtisaari, rekomandoi pavarësinë si status final për Kosovën dhe paraqiti një

kornizë gjithëpërfshirëse për shtetin e ri, që, sipas tij, përfshin disa nga garancitë kushtetuese më të gjera në Evropë sa u përket komuniteteve joshumicë.

Konjufca ka thënë se shpallja e pavarësisë ishte kulmim i këtij procesi politik dhe historik, teksa ka kujtuar se më 2010, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë tha se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk ka shkelur të drejtën ndërkombëtare. “Pikërisht për këto arsye, përpjekjet e Rusisë për të përdorur Kosovën si precedent apo si justifikim për pushtimin, okupimin ose përpjekjen për aneksimin e territorit ukrainas janë historikisht dhe juridikisht të pavërteta. Nuk ekziston një paralele e tillë”, është shprehur Konjufca.

Presidenti rus, Vladimir Putin, në të kaluarën e ka përmendur disa herë Kosovën. Në prill të vitit 2022, Putin ka thënë se, nëse Kosova mundet të shpallë pavarësinë, pse nuk munden Donjecku dhe Luhansku, duke iu referuar dy rajoneve separatiste ukrainase, që Rusia në shkurt të atij viti i njohu si shtete të pavarura.

“Është fakt që shumë shtete perëndimore e kanë njohur Kosovën si shtet të pavarur. Ne e kemi bërë të njëjtën gjë me republikat e Donbasit”, kishte thënë Putin më 26 prill 2022 gjatë një takimi me sekretarin e përgjithshëm të OKB-së.

Ai po ashtu e ka krahasuar edhe aneksimin e Krimesë nga Rusia me Kosovën. Kosova vazhdimisht ka kundërshtuar këto krahasime. Konjufca po ashtu ka kujtuar se, pavarësisht mosnjohjes, Kosova e ka mbështetur Ukrainën që nga dita e parë e luftës, e ka dënuar pushtimin, ka vendosur sanksione ndaj Rusisë dhe Bjellorusisë, ka ofruar ndihmë financiare dhe ka strehuar gazetarë ukrainas, si dhe ka ofruar trajnime ushtarake. “Po aq e rëndësishme është të rikujtohet një dallim i qartë: përderisa Kosova ka vendosur sanksione ndaj Rusisë, Serbia nuk është përafëruar me sanksionet e BE-së të vendosura në përgjigje të luftës së agresionit të Rusisë kundër Ukrainës”, është shprehur ai. Serbia refuzon të pranojë pavarësinë e Kosovës dhe në Kushtetutën serbe, Kosova është ende pjesë e territorit të saj.



Në Prishtinë largohet flamuri ukrainas

Konjufca është zyrtari i parë qeveritar që ka reaguar ndaj deklaratës së Zelenskyt në Beograd. Megjithatë, më herët gjatë 9 gushtit, Komuna e Prishtinës ka ndërmarrë një veprim për të kundërshtuar atë që udhëheqësi ukrainas ka thënë. Komuna e ka larguar një flamur të vendosur në qendër të qytetit, me mbishkrimin “Free Ukraine” (Liri për Ukrainën). “Shteti i Kosovës duhet të respektohet. Kur Kosova nuk respektohet, kryeqyteti, Prishtina përgjigjet gjithmonë njëjtë”, është shprehur kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, në një postim në rrjetet sociale. Flamuri ishte vendosur në qendër të Prishtinës pas shpërthimit të luftës, në shenjë solidariteti me Ukrainën. Rama ka thënë se populli i Kosovës gjithmonë solidarizohet me popujt që përballen me luftë, dhunë dhe përndjekje, sepse “e dimë çfarë do të thotë të luftosh për liri, dinjitet dhe të drejtën për të ekzistuar si shtet”.

“Por, asnjë kauzë dhe asnjë politikë nuk mund të ndërtohet duke nënçmuar shtetësinë e Kosovës dhe sakrificën e popullit të saj”, ka shtuar ai.

Shqipëria i reagon Zelenskyt: Barazimi i Kosovës me një situatë tjetër ndërkombëtare është i gabuar

Lidhur me deklaratën e Zelenskyt ka reaguar edhe Shqipëria. Ministria për Evropë dhe Punë të Jashtme e Shqipërisë e ka cilësuar të gabuar çdo përpjekje për të tërhequr paralele mes Kosovës dhe situatave të tjera ndërkombëtare. “Nuk duhet të ketë asnjë keqkuptim në këtë pikë: çdo përpjekje për të tërhequr paralele apo për të barazuar Kosovën me ndonjë situatë tjetër ndërkombëtare është e gabuar, oportuniste dhe krejtësisht e pasaktë”, është thënë në reagimin e 9 gushtit. Shqipëria ka thënë se Kosova ka themelet e saj historike, politike

dhe ligjore, duke kujtuar edhe një vendim të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) lidhur me vendimin e Kosovës për të shpallur pavarësinë më 2008. “Me kërkesë të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, GJND-ja ishte e prerë: shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk e ka shkelur të drejtën ndërkombëtare. Agresioni i Rusisë ndaj Ukrainës është një çështje krejtësisht tjetër. Ai përbën shkelje të rëndë të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe të së drejtës ndërkombëtare, si dhe një shkelje flagrante të rendit ndërkombëtar të bazuar në rregulla”, është thënë në reagimin e Ministrisë së Jashtme të Shqipërisë.

Sipas Shqipërisë, paqja në Ballkanin Perëndimor dhe e ardhmja evropiane e rajonit kërkojnë “pranimin e realitetit të pakthyesëm të pavarësisë së Kosovës”. “Pavarësia e Kosovës ka kontribuar në stabilitetin rajonal dhe është pjesë e një të ardhmeje në të cilën kufijtë nuk ndryshohen përmes forcës dhe popujt e komunitetet mund ta përcaktojnë të ardhmen e tyre në paqe dhe siguri”, është thënë në reagim.

Shqipëria, vend anëtar i NATO-s dhe kandidate për anëtarësim në BE, ka përsëritur qëndrimin se mbështet sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës. Tirana ka thënë se është “e kuptueshme” dhe “legjitime” që vizita e Zelenskyt në Serbi, para së gjithash, i shërben interesave të Ukrainës. Megjithatë, ka shtuar se çdo hap që i ndihmon Serbinë të largohet “nga ndikimi keqdashës i Rusisë dhe të afrohet me Evropën është pozitiv”. Edhe pse është kandidate për anëtarësim në BE, Serbia për gati pesë vjet nuk ka hapur asnjë kapitull të ri negociues. Dy muaj pas hapjes së kapitullit të fundit në negociatat për anëtarësim filloi lufta në Ukrainë, ndërsa Serbia nuk e harmonizoi politikën e saj të jashtme me bllokun për të sanksionuar Rusinë. Në atë kohë, kjo ishte arsyeja kryesore për ngecjen e negociatave të anëtarësimit, teksa ndërkohë Beogradi ka pasur përkeqësim edhe në fushën e sundimit të ligjit.



Komuna e Skenderajt vazhdon mbulimin e shpenzimeve të varrimit për familjet

SKENDERAJ, 10 GUSHT - Komuna e Skenderajt ka njoftuar se do të vazhdojë të mbulojë financiarisht shërbimin e varrimit për familjet në të gjithë territorin e komunës edhe në vitet e ardhshme. Për këtë qëllim, kryetari i Komunës së

Skenderajt, Sami Lushtaku, së bashku me kryetarin e Këshillit të Bashkësisë Islame në Skenderaj, Ibrahim Hoti, kanë nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi për vazhdimin e mbulimit financiar të këtij shërbimi. Sipas Komunës së

Skenderajt, mbështetja synon t'ua lehtësojë familjeve barrën financiare në një prej momenteve më të vështira për to. “Në momente të vështira për familjet, mbështetja institucionale është përgjegjësi dhe përkushtim”, është thënë në

njoftimin e Komunës së Skenderajt. Komuna e Skenderaj ka theksuar se do të vazhdojë të jetë pranë qytetarëve dhe familjeve në të gjithë territorin e saj, veçanërisht në periudhat kur kanë më së shumti nevojë për



mbështetje. “Pranë qytetarëve dhe familjeve të Skenderajt, atëherë kur kanë më së shumti nevojë”, është thënë në njoftim.

KFOR-i nis tranzicionin gradual në Kosovë, integron policinë në sigurinë e Manastirit të Deçanit dhe largohet nga ura e Ibrit

PRISHTINË, 10 GUSHT - Misioni i KFOR-it, i udhëhequr nga NATO, ka nisur të hënën integrimin e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës në arkitekturën e sigurisë së KFOR-it në manastirin e Deçanit. Sipas KFOR-it, ky proces zhvillohet në kuadër të përmirësimit të situatës së sigurisë në Kosovë dhe është pjesë e procesit për optimizimin e prezencës së misionit. Sipas njoftimit të KFOR-it, integrimi do të zhvillohet në mënyrë graduale dhe në bazë të kushteve të sigurisë.

KFOR-i ka bërë me dije se procesi është duke u koordinuar ngushtë me një sërë aktorësh, përfshirë përfaqësuesit e Kishës Ortodokse Serbe, institucionet e Kosovës, Policinë e Kosovës dhe Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX). “Angazhimi i KFOR-it



për sigurinë e Manastirit të Deçanit dhe për sigurinë e të gjitha komuniteteve lokale është i palëkundur. Personeli ynë është i përgatitur mirë për t'iu përgjigjur çdo zhvillimi përkatës, në përputhje me mandatin e KFOR-it në OKB. KFOR-i mbetet reaguesi i parë për sigurinë e

Manastirit të Deçanit”, është thënë në komunikatën e KFOR-it. Më tutje, misioni i NATO-s në Kosovë është shprehur se është e rëndësishme që të gjitha palët të angazhohen në mënyrë konstruktive në dialog dhe bashkëpunim.

KFOR-i është shprehur se vazhdon të përmbushë mandatin e tij, duke kontribuar në ruajtjen e një mjedisi të sigurt dhe të qetë për të gjithë njerëzit që jetojnë në Kosovë, si dhe në garantimin e lirisë së lëvizjes, në çdo kohë, në mënyrë të paanshme dhe në koordinim të ngushtë me Policinë e Kosovës dhe Misionin e BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë

(EULEX), në rolet e tyre përkatëse si reagues të sigurisë. Po ashtu, KFOR-i ka njoftuar se ka nisur “tranzicionin gradual të pranisë” së tij të përhershme nga ura kryesore mbi lumin Ibër në Mitrovicë. Në një deklaratë për “Radion Evropa e Lirë”, KFOR-i ka thënë se ky hap po ndërmerret në përputhje me përmirësimin e situatës së sigurisë në Kosovë. “Misioni KFOR, i udhëhequr nga NATO-ja, ka filluar tranzicionin gradual të pranisë së përhershme të KFOR-it nga ura kryesore në Mitrovicë. Në përputhje me përmirësimin e situatës së sigurisë në Kosovë, kjo është pjesë e procesit për optimizimin e pozicionimit të KFOR-it”, është thënë në përgjigjen e KFOR-it.



PRISHTINA NIS HARTIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR QEVERISJE TË HAPUR 2026-2029

PRISHTINË, 10 GUSHT - Komuna e Prishtinës ka nisur procesin e bashkëhartimit të Planit të Veprimit për Qeverisje të Hapur 2026-2029, në kuadër të iniciativës OGP Local. Sipas njoftimit të Komunës së Prishtinës, takimi i parë me organizatat e shoqërisë civile ka shënuar nisjen zyrtare të këtij procesi, ku janë diskutuar rezultatet dhe mësimet e nxjerra nga zbatimi i planit për periudhën 2024-2025. “Gjatë takimit u prezantuan rezultatet dhe mësimet nga zbatimi i planit 2024-2025, metodologjia për hartimin e planit të ri, si dhe mundësitë për përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile

dhe akterëve të tjerë”, është thënë në njoftimin e Komunës së Prishtinës. Diskutimet janë përqendruar në disa prej fushave kryesore të qeverisjes së hapur, përfshirë transparencën, llogaridhënien, pjesëmarrjen e qytetarëve dhe qeverisjen digjitale. “Diskutimet u përqendruan në transparencën, llogaridhënien, pjesëmarrjen e qytetarëve dhe qeverisjen digjitale”, është thënë më tutje në njoftim. Në takim është diskutuar edhe krijimi i Forumit Shumëpalësh për Qeverisje të Hapur, i cili synohet të shërbejë si mekanizëm konsultativ për gjatë procesit të hartimit dhe zbatimit



të planit. “Po ashtu, u diskutua krijimi i Forumit Shumëpalësh për Qeverisje të Hapur, i cili do të shërbejë si mekanizëm konsultativ gjatë hartimit, monitorimit dhe vlerësimit të

zbatimit të planit”, ka njoftuar Komuna e Prishtinës. Ndërkohë, Komuna e Prishtinës ka bërë me dije se hapat e ardhshëm përfshijnë formalizimin e forumit, zhvillimin

e një ankete online, organizimin e një punëtorie për bashkëkrijimin e zotimeve, si dhe vazhdimin e konsultimeve me palët e interesuara. “Hapat e ardhshëm përfshijnë formalizimin e Forumit, zhvillimin e një ankete online, organizimin e një punëtorie për bashkëkrijimin e zotimeve dhe vazhdimin e konsultimeve. Plani pritet të finalizohet dhe të prezantohet në muajin nëntor”, është thënë në njoftim. Procesi i hartimit të planit mbështetet nga Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale i Këshillit të Evropës, përmes projektit “Forcimi i qeverisjes shumënivëlshme dhe demokracisë pjesëmarrëse”.

Policia e Kosovës ndan 14 automjete hibride për policët e lagjes

PRISHTINË, 10 GUSHT - Policia e Kosovës ka ndarë 14 automjete të reja hibride për policët e lagjes, me qëllim rritjen e efikasitetit në terren dhe forcimin e bashkëpunimit me komunitetin. Menaxhmenti i Policisë së Kosovës po vazhdon përpjekjet për përmirësimin e kushteve të punës dhe rritjen e efikasitetit të policëve të lagjes, duke synuar që ata të jenë më të pranishëm dhe më afër qytetarëve dhe nevojave

të komunitetit. Në kuadër të zbatimit të objektivave të Strategjisë së Policimit të Drejtuar nga Inteligjenca dhe Policimit në Bashkësi, si dhe forcimit të qasjes proaktive ndaj kërkesave të qytetarëve, Policia e Kosovës ka vazhduar mbështetjen për Divizionin e Policisë në Bashkësi dhe Parandalim. Sipas policisë, automjetet e reja do të mundësojnë që policët e

lagjes të kenë mobilitet më të madh gjatë angazhimeve të tyre në terren dhe të jenë më efikasë në adresimin e kërkesave të qytetarëve. Kjo mbështetje synon gjithashtu forcimin e komunikimit dhe bashkëpunimit të drejtpërdrejtë ndërmjet Policisë së Kosovës dhe komuniteteve, në funksion të parandalimit të dukurive negative dhe rritjes së sigurisë publike.



ANTERO LOPES MERR DETYRËN SI SHEF I EULEX-IT NË KOSOVË

PRISHTINË, 10 GUSHT - Antero Lopes, drejtues i lartë ndërkombëtar nga Portugalia, ka marrë detyrën e shefit të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX). Lopes është shprehur i nderuar që do të udhëheqë misionin evropian, duke theksuar rolin e EULEX-it si partner i institucioneve të sundimit të ligjit në Kosovë. “Jam i nderuar që po marr detyrën e Shefit të EULEX-it dhe që do të udhëheq një Mision i cili, për shumë vite, ka shërbyer si partner i besueshëm dhe i paanshëm i institucioneve të sundimit të ligjit në Kosovë. Ekipi i larmishëm dhe profesional i EULEX-it vazhdon të jetë i përkushtuar fuqishëm për mbështetjen e një sektori të sundimit të ligjit të përgjegjshëm dhe të pavarur, i cili është thelbësor për qeverisjen demokratike, sigurinë juridike, besimin e publikut dhe stabilitetin afatgjatë, në dobi të të gjitha komuniteteve në Kosovë”, është shprehur Lopes.

Ai ka bërë me dije se gjatë mandatit të tij do të synojë bashkëpunim të ngushtë me institucionet e Kosovës, partnerët e Bashkimit Evropian dhe komunitetin ndërkombëtar. “Duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet e Kosovës, partnerët e Bashkimit Evropian dhe komunitetin e gjerë ndërkombëtar, jam i përkushtuar të siguroj që Misioni të vazhdojë të ofrojë këshillim strategjik, monitorim dhe mbështetje operative në përputhje me mandatin e tij, duke promovuar njëkohësisht qëndrueshmërinë institucionale, profesionalizmin, integritetin, respektimin e plotë të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si dhe barazinë gjinore”, ka deklaruar ai. Lopes ka theksuar se një sistem i pavarur dhe i paanshëm i sundimit të ligjit është i rëndësishëm për funksionimin e institucioneve demokratike dhe perspektivën evropiane të Kosovës. “Një sistem i sundimit të ligjit që është i pavarur, i paanshëm dhe i lirë nga ndikimi i papërshtatshëm



politik është i domosdoshëm për mbrojtjen e institucioneve demokratike dhe avancimin e perspektivës evropiane të Kosovës”, është shprehur ai. Shefi i ri i EULEX-it ka shprehur gatishmërinë për të bashkëpunuar drejtpërdrejt me institucionet dhe homologët në Kosovë, me synim arritjen e rezultateve konkrete. “Pres me kënaqësi të angazhohem nga

afër me homologët tanë, t’i dëgjoj prioritetet e tyre dhe të punojmë së bashku për të arritur përparim konkret dhe të qëndrueshëm, i cili do ta forcojë më tej sundimin e ligjit dhe do të kontribuojë gjithashtu në stabilitetin dhe sigurinë rajonale”, ka përfunduar Lopes. Sipas EULEX-it, Lopes sjell me vete 40 vjet përvojë kombëtare dhe ndërkombëtare, përfshirë

pothuajse tri dekada në funksione të larta udhëheqëse në kuadër të Kombeve të Bashkuara.

Ai ka shërbyer për rreth gjashtë vjet në Kosovë dhe, sipas Misionit, e njëj mirë kontekstin e vendit. Përvoja e tij përfshin diplomacinë, sundimin e ligjit, qeverisjen e sektorit të sigurisë, menaxhimin e krizave, ndërmjetësimin dhe reformat institucionale.

Mandati i Lopes do të zgjasë deri më 14 qershor 2027. Ai pason Giovanni Pietro Barbanon, gjeneralmajor italian i Karabinierisë Italiane, i cili ka përfunduar mandatin si Shef i EULEX-it në qershor 2026. EULEX-i është themeluar në vitin 2008 si misioni më i madh civil në kuadër të Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes (CSDP) të Bashkimit Evropian. Në qershor 2025, Këshilli i Bashkimit Evropian e ka zgjatur mandatin e EULEX-it deri më 14 qershor 2027, në bazë të Vendimit (CFSP) 2025/1161.

HARADINAJ PARALAJMËRON KURTIN: RRUGA E VETMJA ZGJIDHJE PËR TA KTHYER NË BINARË KOSOVËN. SHTATORI PO VJEN, ALBIN

PRISHTINË, 10 GUSHT - Anëtari i Kryesisë së Aleancës, Daut Haradinaj, i ka adresuar një mesazh të ashpër kryeministrit në detyrë, Albin Kurti, duke deklaruar se “rruga është e vetmja rrugë” për ta rikthyer Kosovën, sipas tij, në binarët e një shteti demokratik. Haradinaj ka renditur në “Facebook” një varg kritikash ndaj qeverisjes, duke përmendur raportet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, qëndrimin ndaj Serbisë, energjinë, trajtimin e qytetarëve, prodhuesit vendorë, punëtorët,



policinë, ushtrinë, arsimin dhe shëndetësinë. “Ku aleati historik, Amerika, respektohet. Ku Serbia sanksionohet me 100 për qind.

Ku rryma prodhohet në Kosovë e nuk blihet në Serbi me mbi 1 miliard euro. Ku projektet amerikane janë strategji

shtetërore e jo tallje”, ka shkruar Haradinaj.

Ai ka kërkuar gjithashtu një shtet që, sipas tij, i trajton qytetarët në mënyrë të barabartë, mbështet prodhuesit vendorë dhe krijon kushte që familjet të ndërtojnë të ardhmen në Kosovë. “Ku rrugët ndërtohen e nuk shkatërrohen. Ku shteti i trajton qytetarët e vet të barabartë, e jo me ne dhe ata. Ku punohet e nuk flitet. Ku vlera respektohet e nuk anatemohet. Ku prodhuesi i Kosovës e ka shtetin partner e jo armik. Ku tregu i Kosovës është për

kosovarët. Ku punëtorit i respektohet puna. Ku ushtari nuk të padit. Ku polici ka dinjitet. Ku arsimi është prioritet. Ku spitali të shëron e jo të sëmurë. Ku familja rritet në Kosovë e jo në Skandinavi. Ku populli nuk gënjehet, por i thuhet e vërteta. Aty ku serbët nuk lejohen të regjistrohen me dëshmitarë edhe pas krimeve të kryera”, ka shkruar Haradinaj. Reagimin e tij, Daut Haradinaj e ka përmbyllur me një paralajmërim të drejtpërdrejtë për Kurtin: “Pra, shtatori po vjen, Albin”.

GASHI PRET NË TAKIM DREJTORIN E AKADEMISË SË DREJTËSISË, DISKUTOJNË PËR TRAJNIMIN E PROKURORËVE

PRISHTINË, 10 GUSHT - Kryeprokurori i Shtetit, Zejnulla Gashi, ka pritur në takim drejtorin e Akademisë së Drejtësisë, Enver Fejzullahu, i cili e ka uruar Gashin për marrjen e detyrës së re. Sipas njoftimit, gjatë takimit është diskutuar për çështje me rëndësi për sistemin prokurorial, me fokus në ngritjen dhe zhvillimin e vazhdueshëm të kapaciteteve profesionale të prokurorëve përmes organizimit dhe mbajtjes së trajnimeve të specializuara. “Të dy bashkëbiseduesit diskutuan për çështje me rëndësi për sistemin

prokurorial, me theks të veçantë për ngritjen dhe zhvillimin e vazhdueshëm të kapaciteteve profesionale të prokurorëve përmes organizimit dhe mbajtjes së trajnimeve të specializuara”, është thënë në njoftimin e Prokurorit të Shtetit. Sipas njoftimit, trajnimet synojnë avancimin e njohurive dhe aftësive profesionale të prokurorëve, veçanërisht në trajtimin sa më efikas të formave të sofistikuara dhe komplekse të kriminalitetit bashkëkohor. “Me qëllim të avancimit të njohurive dhe aftësive profesionale të



prokurorëve në trajtimin sa më efikas të formave të sofistikuara dhe komplekse të kriminalitetit

bashkëkohor”, është thënë në njoftim. Gashi dhe Fejzullahu kanë

vlerësuar gjithashtu rëndësinë e bashkëpunimit institucional për përcaktimin e temave të trajnimeve, në mënyrë që ato të adresojnë sfidat me të cilat përballen prokurorët gjatë punës së tyre. “Kryeprokurori i Shtetit dhe drejtori i Akademisë së Drejtësisë vlerësuan rëndësinë e bashkëpunimit të ndërsjellë institucional në identifikimin e temave përkatëse për trajnim që adresojnë sfidat dhe nevojat e kohës me të cilat përballen prokurorët gjatë ushtrimit të detyrave të tyre”, është thënë në njoftim.

KOSOVA, E VARUR NGA IMPORTET

PRISHTINË, 10 GUSHT - Importet vazhdojnë të rriten nga viti në vit, duke vendosur rekorde të reja dhe duke zgjeruar hendekun mes asaj që Kosova blen nga jashtë dhe asaj që arrin të shesë. Të dhënat e Doganës së Kosovës, Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe Odës Ekonomike të Kosovës tregojnë se ekonomia mbetet e mbështetur kryesisht në mallrat e importuara. Ekonomia e Kosovës është duke importuar mallra me ritëm gjithnjë e më të lartë. Brenda rreth pesë vjetësh e gjysmë, nga fillimi i vitit 2021 deri në fund të muajit maj 2026, vlera e mallrave të importuara ka kaluar shifrën prej 32 miliardë eurosh. Të dhënat zyrtare të Doganës së Kosovës tregojnë se vetëm gjatë pesë muajve të parë të vitit 2026, vendi ka importuar mallra në vlerë prej 2.92 miliardë eurosh. Kjo shumë është rreth 150 milionë euro më e lartë se në të njëjtën periudhë të vitit paraprak dhe mbi gjysmë miliard euro më e lartë kra-

hasuar me 5-mujorin e vitit 2024. Nëse këtij 5-mujori i shtohen importet e regjistruara gjatë viteve 2021–2025, të cilat arrijnë në rreth 29.35 miliardë euro, rezulton se në më pak se gjashtë vjet, ekonomia e Kosovës ka shpenzuar mbi 32 miliardë euro për blerjen e mallrave nga jashtë. Këto shifra tregojnë përmasa gjithnjë e më të mëdha të tregtisë importuese, por edhe faktin se pjesa më e madhe e konsumit në Kosovë vazhdon të mbështetet në produkte të prodhuara jashtë vendit.

Rekord pas rekordi në importe

Analiza e të dhënave vjetore të Doganës së Kosovës tregon rritje të pandërprerë të importeve gjatë gjithë periudhës së analizuar. Në vitin 2021, Kosova importoi mallra në vlerë prej rreth 4.65 miliardë eurosh. Një vit më vonë, importet u rritën në 5.60 miliardë euro, duke shënuar zgjerimin më të madh



vjetor të kësaj periudhe. Brenda vetëm një viti, fatura e importeve u rrit me afro 954 milionë euro, ose 20.5 për qind, rritje që lidhej me rimëkëmbjen ekonomike pas pandemisë, rritjen e çmimeve në tregjet ndërkombëtare dhe zgjerimin e konsumit të brendshëm. Pas këtij kërcimi të fortë, ritmi u ngadalësua në vitin 2023, kur importet arritën në 5.77 miliardë euro. Rritja ishte rreth 164 milionë euro, ose 2.9 për qind, norma më e ulët e regjistruar gjatë viteve të fundit. Megjithatë, ngadalësimi rezultoi i përkohshëm. Në vitin 2024, importet u rritën përsëri në 6.33 miliardë euro, duke u zgjeruar me rreth 561 milionë euro krahasuar me vitin paraprak. Ndërsa viti 2025 solli një tjetër

rekord historik. Për herë të parë, vlera e mallrave të importuara kaloi pragun e 7 miliardë eurove, duke arritur në rreth 7.0 miliardë euro. Krahasuar me vitin 2024, importet u rritën me mbi 672 milionë euro, duke e bërë vitin 2025 periudhën me nivelin më të lartë të importeve të regjistruar ndonjëherë në Kosovë. Në tërësi, gjatë periudhës 2021–2025, importet janë zgjeruar me rreth 50.6 për qind, ndërsa norma mesatare vjetore e rritjes ka qenë 10.8 për qind. Praktikisht, çdo vit ka sjellë më shumë mallra të importuara dhe një faturë financiare gjithnjë e më të lartë për ekonominë kosovare.

Tendenca është duke vazhduar edhe në vitin 2026

Shifrat e 5-mujorit të parë të këtij viti tregojnë se dinamika nuk ka ndryshuar. Nga janari deri në fund të majit 2026, importet kanë arritur në 2.92

miliardë euro. Nëse ritmi aktual ruhet edhe në muajt e mbetur të vitit, importet pritet të mbeten pranë rekordit të vendosur gjatë vitit 2025. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025, importet janë rritur me rreth 150 milionë euro, ndërsa në raport me 5-mujorin e vitit 2024, zgjerimi kalon 500 milionë euro. Rritja e vazhdueshme e importeve ka ardhur paralelisht me zgjerimin e konsumit të brendshëm dhe me rritjen e kërkesës për produkte të huaja, ndërkohë që prodhimi vendor nuk ka arritur të ndjekë të njëjtin ritëm. Një pjesë e konsiderueshme e kësaj fature lidhet me importin e derivateve të naftës, energjisë elektrike, makinerive, pajisjeve industriale, automjeteve, materialeve ndërtimore dhe produkteve ushqimore, kategori që prej vitesh dominojnë strukturën e importeve të Kosovës. Edhe pse eksportet kanë shënuar rritje në disa sektorë gjatë viteve të fundit, ritmi i tyre ka mbetur dukshëm më i ulët sesa ai i importeve.

RAFUNA: RREDITJA E ÇMIMIT TË NAFTËS PO UA RREDIT KOSTOT BIZNESEVE, MUND TË TKURRË PRODHIMIN DHE TË RREISË PAPUNËSINË

PRISHTINË, 10 GUSHT - Rritja e çmimit të derivateve të naftës po shihet si një tjetër goditje për bizneset në Kosovë, duke shtuar kostot operative dhe duke rrezikuar konkurrueshmërinë e prodhimeve vendore përballë importeve. Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Lulzim Rafuna, ka thënë për “Ekonomia Online” se rritja e mëtejshme e çmimeve të naftës dhe mungesa e masave institucionale mund të sjellin tkurrje të prodhimit, rritje të importeve dhe humbje të vendeve të punës. Duke folur për ndikimin e çmimeve të derivateve te bizneset, Rafuna ka deklaruar se rritja e çmimit të naftës përkethehet drejtpërdrejt në rritje të kostove operative. “Bizneseve u ka rritur koston e prodhimit. Rritja e çmimit të derivateve të naftës është rritje e koston operative për çdo biznes. Rritje e koston

operative që reflektohet në prodhim ose në shërbim që ofrojnë kompanitë tona. Pa dyshim që mosndërmarrja e asnjë mase për ta mundësuar, për ta lehtësuar, sidomos disa sektorë që janë më strategjikë dhe më të ndjeshëm siç është sektori i bujqësisë, sektori i prodhimit, sektori i transportit rrugor, sektori i transportit të udhëtarëve, qoftë i brendshëm, qoftë i jashtëm e kështu me radhë pa dyshim që ka ndikuar negativisht dhe nuk i ka bërë konkurrentë kundrejt prodhimeve të huaja që po importohen në vendin tonë”, ka thënë Rafuna. Sipas tij, produktet vendore në disa raste tashmë janë më të shtrenjta se ato të importuara, edhe për shkak të politikave fiskale dhe subvencioneve në shtetet prej nga importohen këto produkte. Rafuna ka bërë me dije se OEK-u u



ka kërkuar institucioneve masa fiskale për lehtësimin e barrës së bizneseve, përfshirë ndërhyrjen në akcizë dhe TVSh. “Kështu që ne me kohë kemi kërkuar, kemi ofruar studim, kemi dorëzuar dokumente të shkruara te Qeveria për ta ndihmuar që të marrë veprime të politikave fiskale, sidomos te normat e tatimit te akcizës ose ta reduktojë, ose ta eliminojë për një kohë të caktuar, apo edhe të tatimit të vlerës së shtuar, për shkak se efekti në buxhetin e shtetit kishte me qenë zero”, ka deklaruar Rafuna. Ai ka paralajmëruar se situata mund të rëndohet nëse çmimet e

naftës vazhdojnë të rriten dhe institucionet nuk ndërmarrin masa. “Jo, në qoftë se na ndodh kjo, që do të ketë rritje më të tutjeshme të çmimit të derivateve të naftës dhe nuk ndërmerrin ndonjë veprim nga institucionet tona (tani nga qeveria në detyrë siç po quhet), ka me u tkurrur prodhimi ynë, ka me na u rritur importi, edhe do të vazhdojmë me krizën tonë ku shumë punëtorë do të jenë pa punë. Për shkak se kur tkurret prodhimi, duhet t'i lirosh punëtorët, se nuk i ke mundësitë t'i mbash edhe punëtorët”, ka thënë kryetari i OEK-ut. Rafuna ka marrë si shembull sektorin e bujqësisë, duke thënë se mungesa e ndërhyrjeve në kohën e duhur ka ndikuar në rritjen e importeve të produkteve bujqësore. Rafuna është shprehur se mungesa e fuqisë punëtore po i shtyn bizneset të investojnë më

shumë në makineri. “Ka mungesë të fuqisë punëtore. Kjo i ka shtyrë bizneset që të investojnë më shumë në makineri, është investim shtesë. Mirëpo i domosdoshëm për me pa në afatmesëm edhe në afatgjatë që sadopak me zbutur këtë mungesën e fuqisë punëtore”, ka thënë Rafuna. Ai ka bërë me dije se OEK-u, në bashkëpunim me donatorë dhe partnerë ndërkombëtarë, po punon për zhvillimin e mësimin dual për të adresuar mungesën e fuqisë punëtore. “Në krahun tjetër jemi duke punuar ne si Odë Ekonomike me gjithë donatorët, me Qeverinë e Luksemburgut, me LuxDev-in, me qeverinë gjermane përmes GIZ-it, me qeverinë zvicerane përmes Swisscontact-it, që ta zhvillojmë sa më shumë mësimin dual, në mënyrë që ta zbusim këtë mungesën e fuqisë punëtore”, ka shtuar Rafuna.

AKB-ja kërkon hetim për fushatat kundër produkteve vendore

PRISHTINË, 10 GUSHT - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) është shprehur lidhur me fushatat dhe deklaratat që, sipas saj, dëmtojnë besimin e konsumatorëve ndaj produkteve vendore, duke kërkuar nga institucionet që të hetojnë çdo dyshim për veprime të organizuara kundër prodhimit “Made in Kosovo”. AKB-ja ka vlerësuar se kontrollat e produkteve ushqimore janë të domosdoshme, por kërkon që ato të zbatohen në mënyrë të barabartë si për prodhuesit vendorë, ashtu edhe për

produktet e importuara. “Kush po e sulmon prodhuesin vendor? Kush po garanton se produktet e importuara kontrollohen me të njëjtin standard? Dhe pse konsumatori kosovar duhet të ketë më shumë siguri për një produkt që prodhohet në Kosovë se sa për një produkt që vjen nga jashtë?”, është thënë në reagimin e AKB-së. Sipas kësaj organizate, nuk duhet të ketë standarde të dyfishta në kontrollin e produkteve që dalin në treg. “AKB-ja nuk është kundër kontrolleve. Përkundrazi,

kontrollat e rrepta janë të domosdoshme për çdo produkt që hyn në tregun e Kosovës. Por kontrolli duhet të jetë i njëjtë për të gjithë”, është thënë në reagimin e AKB-së, duke kërkuar gjithashtu transparencë më të madhe nga institucionet, veçanërisht nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUUV), lidhur me kontrollat dhe analizat laboratorike. Në veçanti, AKB-ja ka kërkuar përgjigje institucionale edhe për shqetësimet e ngritura nga prodhuesit vendorë lidhur me përdorimin e qumështit pluhur

dhe vajrave bimore. Më tutje, AKB-ja ka shprehur shqetësim edhe për pretendimet se mund të ketë interesa të caktuara tregtare që synojnë krijimin e mosbesimit ndaj produkteve “Made in Kosovo”. Megjithatë, AKB-ja ka theksuar se nuk po akuzon askënd pa prova. Sipas AKB-së, konkurrenca në treg duhet të zhvillohet mbi bazën e cilësisë, çmimit dhe standardeve, e jo përmes diskreditimit të prodhuesve vendorë. Kryetari i AKB-së, Agim Shahini, është shprehur se dobësimi i



prodhimit vendor rrit varësinë e Kosovës nga importi. Ai ka shtuar se marka “Made in Kosovo” duhet të trajtohet si pjesë e fuqisë ekonomike të vendit. “‘Made in Kosovo’ nuk duhet të sulmohet, denigrohet apo përdoret si objekt fushatash, duhet të mbrohet, promovohet dhe të bëhet simbol i fuqisë ekonomike të Kosovës”, është shprehur Shahini.

RICHARD DAWKINS: NË DITËT E SOTME, E VËRTETA NUK KA RËNDËSI - RËNDËSI KA AJO QË NDIEN

Biologu i çiltër flet mbi debatin e "iluzionit" mbi gjininë, shkrimin e romanit të tij të parë dhe arsyen pse nuk do t'i drejtohet Zotit në shtratin e vdekjes



Nga: Leaf ARBUTHNOT /
The Telegraph

Biologu dhe ateisti i famshëm Richard Dawkins, bëri emër me librin e tij të vitit 1976, Gjeni egoist [The Selfish Gene], në të cilin pohoi në mënyrë të paharueshme se qeniet njerëzore ishin "robotë gjigantë e të ngathët", të programuar për të ruajtur gjenet e veta "egoiste". Libri riformësoi përgjithmonë mënyrën se si shumë lexues e kuptonin botën - por, shumë të tjerë i zhyti në dëshpërim. Një lexues australian dëshiroi që të mund ta "ç'lexonte" dhe e fajësoi atë "për një seri periudhash depresioni nga të cilat vuajta për më shumë se një dekadë". Pesëdhjetë vjet pas botimit të librit - dhe me një botim të ri voluminoz për përvjetorin që duhet promovuar - Dawkinsi mohon se depresioni është reagimi i arsyeshëm ndaj tezës së tij se gjenet janë protagonist i madh i jetës në Tokë. "Nuk është dëshpëruese, sepse në të vërtetë nuk ka të bëjë me mënyrën se si ne, si njerëz, duhet të sillemi", këmbëngul ai. "Dua të them, fjala 'egoist'

është në titull, por gjeni egoist krijon individin altruist. Mirësia, po aq sa edhe ligësia, mund të programohet nga gjeni egoist - në varësi të rrethanave ekologjike dhe ekonomike". Ka shumë mënyra, thekson ai, në të cilat qeniet njerëzore rebelohen kundër gjeneve të veta dhe, si shembull, përmend faktin se ai dhe unë "jemi ulur këtu duke biseduar, në vend që të përhapim gjenin tonë", gjë që më bën të skuqem disi. Shembuj të tjerë, thotë ai, përfshijnë matematikën, filozofinë dhe muzikën: "Asgjë nga këto nuk jep ndonjë kontribut të drejtpërdrejtë në përhapjen e gjeneve egoiste. Por, truri ynë është nisur në lloj-lloj drejtimesh të pamundshme". Po flasim në një dhomë me letër dekorative muri në zyrën e [shtëpisë botuese] Oxford University Press, pranë vendit ku Dawkinsi jeton me gruan e tij të katërt Jana Lenzová, 40 vjeçe - ilustruese dhe përkthyesë sllovaqe. Çifti u njoh kur asaj iu ngarkua përkthimi i Iluzionit të Zotit [The God Delusion]; që atëherë, Lenzová ka realizuar ilustrime të bukura

për dy nga librat e Dawkinsit. Tani 85 vjeç dhe i veshur me një këmishë liri, pantallona të errëta dhe ato lloj atletesh praktike që Brezi Z i adhuron, Dawkinsi lëviz disi më me kujdes se dikur. Ai ka hequr dorë nga ngasja e biçikletës nëpër Oksford dhe së fundmi theu krahun pasi u rrëzua në disa shkallë; nuk e ka më krahun në allçi, por krahu ende i dhemb, thotë ai, duke e rrotulluar atë me një mimikë ankimi. Megjithatë, nëse është më i brishtë se dikur - shkëlqimi i vjetër grabitqar i inteligjencës mbetet, ashtu si dhe mungesa e tij e famshme e tolerancës ndaj mendimit irracional. "Për hir të Zotit", rënkoi ai kur përmend interesin që shumë të rinj po tregojnë për astrologjinë. "Dua të them, yjet janë magjepsës - t'i korruptosh ata me këto marrëzira"! Ai është njëjtë i dëshpëruar nga toni i debatit rreth të drejtave të transgjinorëve. "Duket se ideja është se s'ka rëndësi ajo që është objektivisht e vërtetë, ajo që ka rëndësi është mënyra se si ndihesh. Kjo është qesharake. Vetëm sepse ndihesh se je grua - mendoj se mund ta kesh

iluzionin tënd nëse do, por nëse je gjashtë këmbë e katër inçë i gjatë [193 centimetra] dhe merr pjesë në gara noti dhe largohesh me të gjitha medaljet, kjo është thjesht e pander-shme. Është mashtrim". Ajo që ai urren veçanërisht është mënyra se si debati transgjinor ndonjëherë paraqitet si diçka që nuk është aspak e denjë për debat. "Vërtet i përçmoj taktikat e njerëzve transgjinorë, mënyrën se si ata në fakt nuk e argumentojnë çështjen, por thjesht i anulojnë njerëzit. Kjo është e përbuzshme", thotë ai. "Është i tmerrshëm fakti se ata nuk mund të zhvillojnë thjesht një bisedë të qytetëruar ... Nuk mund ta diskutosh. Thjesht, njerëzit anulohen, botuesit detyrohen me presion të anulojnë libra dhe gratë detyrohen të ndërrojnë rrobat përpara meshkujve me organet gjenitale të paprekura, Ata vendosen në burgje për femra ... Është skandal". Çfarë mendon ai për pretendimin se njerëzit e cenusshëm transgjinorë mund të shtyhen drejt vetëvrasjes nëse të drejtat e tyre nuk zgjerohen ose mbrohen?

"Marrëzi. Ky është një mit i madh. Këta të ashtuquajtur njerëz vetëvrasës - ata edhe ashtu janë të çrregulluar mendërisht". Është e vështirë të përfytyrosh shumë intelektualë të tjerë publikë që flasin me kaq pak rezerva për temën e cila shumë të intervistuar i ngushton. Por, sigurisht, Dawkinsi nga natyra është gati për luftë. Gjatë viteve ka bërë kudo armiq, nga kreacionistët (në vitin 2011 bëri fushatë për të ndaluar mësimin e kreacionizmit në shkollë) deri te njerëzit me aftësi të kufizuara (nënat kanë një detyrë morale, ka thënë ai, të abortojnë fetuset që kanë sindromën Daun). I patrembur nga tmerret me të cilat është përballur bashkëkohësi i tij i përafërt Salman Rushdie, Dawkinsi ka qenë krejtësisht i gatshëm ta drejtojë fuqinë e tij intelektuale të zjarrit kundër Islamit. Në vitin 2013, ai theksoi në Twitter: "Të gjithë myslimanët e botës kanë më pak Çmime Nobel se Koleji i Trinisë në Kembrixh [Trinity College]. Megjithatë, ata bënë gjëra të mëdha në Mesjetë". Ndërsa kritikant - siç pritej - fil-



Asllani kthehet në “radarin” e Barcelonës

HOFFENHEIM, 10 GUSHT - Pavarësisht se transferimi i tij te Leipzig dështoi, Fisnik Asllani ka gjasa të largohet nga Hoffenheimi gjatë këtij afati kalimtar. Është bërë me dije se Barcelona ka rikthyer interesimin për Asllanin, pasi

nuk ka arritur ta bindë Atletico Madridin për shitjen e Julian Alvarezit. Barcelona kishte shfaqur interesim edhe më herët për Asllanin, por fokusi te transferimi i Alvarezit ka bërë që sulmuesi kosovar të arrinte marrëveshje me Leipzigun, e cila

në fund nuk është realizuar. Kësisoj, trajneri i Barcelonës, Hansi Flick, i ka dhënë dritën jeshile transferimit të Asllanit në “Camp Nou”, duke pasur parasysh se skuadrës i nevojitet patjetër një sulmues për sezonin e ri. Kartoni i Asllanit vlerësohet

në rreth 30 milionë euro, duke pasur parasysh se ai ka kontratë me Hoffenheimin deri në verën e vitit 2029. Sezonin e kaluar, Asllani shkëlqeu me fanellën e Hoffenheimit, duke shënuar 11 gola dhe duke dhuruar 10 asistime në 35 paraqitje.



FFK-ja ORGANIZON KURSIN E PARË PËR TRAJNERË PËR UEFA PRO LICENCË

PRISHTINË, 10 GUSHT - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) ka shënuar një nga arritjet më të mëdha deri më tani në sektorin e edukimit të trajnerëve, duke fituar në një kohë rekord të drejtën për organizimin e kursit UEFA Pro Licencë në Kosovë. Ky është niveli më i lartë i licencimit të trajnerëve në kuadër të sistemit të edukimit të UEFA-s dhe përfaqëson një hap të rëndësishëm për zhvillimin profesional të trajnerëve dhe avancimin e futbollit kosovar. Organizimi i këtij kursi në Kosovë dëshmon njëherësh progresin e vazhdueshëm të FFK-së në fushën e edukimit, si dhe përmbushjen e standardeve dhe kërkesave të përcaktuara nga UEFA.

Në kuadër të Programit për Edukimin dhe Licencimin e Trajnerëve, FFK-ja ka shpallur konkursin për pranimin e kandidatëve në kursin UEFA Pro Licencë. Në edicionin e parë të këtij kursi do të pranohen gjithsej 18 pjesëmarrës. Procesi i përzgjedhjes së kandidatëve do të përfshijë një provim pranues, i cili do të mbahet më 26-28 tetor 2026. Vetëm kandidatët që i plotësojnë kriteret e përcaktuara për pranim dhe kalojnë me sukses procesin e përzgjedhjes do të pranohen në kurs.

Në përputhje me kërkesat e UEFA Coaching Convention, kandidatët duhet të posedojnë UEFA A Licence të vlefshme, të kenë së paku një vit përvojë pune si trajner në



nivel profesional, si trajner kryesor ose ndihmës-trajner, apo në një rol përkatës me ekip kombëtar, si dhe të ofrojnë dëshmi për përvojën e tyre si trajner, duke përfshirë klubin ose ekipin kombëtar, pozitën e mbajtur dhe nivelin e garës.

Kandidatët duhet të jenë aktivisht të angazhuar si trajnerë dhe të kenë qasje në një ekip me të cilin mund ta realizojnë punën praktike të kërkuar gjatë gjithë kohëzgjatjes së kursit. Gjithashtu, ata duhet të dorëzojnë kopjen e UEFA A Licencës, vërtetimin nga Policia lidhur me dosjen penale dhe certifikatën mjekësore të lëshuar nga institucioni kompetent shëndetësor. Kandidatët janë përgjegjës që gjatë gjithë kohëzgjatjes së kursit të kenë qasje në një ekip, me qëllim të realizimit të detyrave praktike të kërkuara gjatë trajnimit. Nëse gjatë kursit ndryshon

situata e angazhimit të kandidatit si trajner, është përgjegjësi e tij të sigurojë qasje në një ekip të përshtatshëm për të përmbyllur kërkesat praktike të programit.

FFK-ja rezervon të drejtën të kërkojë dokumente ose informacione shtesë gjatë procesit të verifikimit të aplikimeve. Për këtë edicion të Kursit UEFA Pro Licencë, konkursi është i hapur ekskluzivisht për kandidatët që posedojnë pasaportë të Republikës së Kosovës. Në rast se pas përfundimit të procesit të aplikimit dhe përzgjedhjes mbeten vende të lira, FFK-ja rezervon të drejtën të shpallë një konkurs shtesë të veçantë, i cili mund të jetë i hapur edhe për kandidatë ndërkombëtarë që i plotësojnë kriteret e kërkuara për pranim. Çdo konkurs i tillë shtesë do të shpallet veçmas nga FFK-ja dhe do të përmbajë kriteret përkatëse të pranimin,

procedurën e aplikimit dhe afatin për aplikim. Kursi UEFA Pro Licencë është një program gjithëpërfshirës edukimi, i cili përbëhet nga module rezidenciale me pjesëmarrje fizike, sesione teorike dhe praktike në fushë, mësim online, detyra individuale dhe grupe, punë praktike si trajner në kuadër të klubit ose ekipit, analiza, vlerësime dhe provime. Kalendar i planifikuar i moduleve me pjesëmarrje fizike nis me provimin pranues më 26-28 tetor 2026, ndërsa më pas do të zhvillohet Moduli Prezantues më 30 nëntor -2 dhjetor 2026. Moduli 1 është planifikuar të mbahet më 1-4 shkurt 2027, moduli 2 më 5-8 prill 2027, moduli 3 më 7-10 qershor 2027, moduli 4 më 2-5 gusht 2027, moduli 5 më 4-7 tetor 2027, moduli 6 më 6-9 dhjetor 2027, moduli 7 më 7-10 shkurt 2028, moduli 8 më 3-6 prill 2028 dhe moduli 9 më 5-8 qershor 2028. Datat e paraqitura i referohen moduleve me pjesëmarrje fizike në Kosovë. Megjithatë, procesi i edukimit do të vazhdojë edhe gjatë periudhave ndërmjet moduleve. Ndërmjet moduleve me pjesëmarrje fizike, pjesëmarrësit do të jenë të obliguar të realizojnë aktivitete të ndryshme mësimore, duke përfshirë detyra praktike të trajnimit me ekipet e tyre, detyra individuale dhe grupe, analiza, aktivitete të mësimin online dhe detyra të tjera të

përcaktuara në kuadër të Programit për Edukimin e Trajnerëve. Kandidatët duhet të jenë të gatshëm t'i përkushtohen kohëzgjatjes së plotë dhe të gjitha kërkesave të programit, si gjatë moduleve të planifikuara me pjesëmarrje fizike, ashtu edhe gjatë periudhave ndërmjet tyre. Programi do të përfshijë gjithashtu module të mësimin online përmes platformës Edubreak. Kandidatët pritet të marrin pjesë në mënyrë aktive në të gjithë komponentët teorikë dhe praktikë të kursit dhe duhet të jenë të përgatitur fizikisht për kërkesat praktike të programit. Kursi do të përfundojë me procesin përkatës të vlerësimit dhe provimeve. Kandidatët që i përmbyllin me sukses të gjitha kërkesat e programit dhe kalojnë vlerësimet e kërkuara do të pajisen me UEFA Pro Licence, në përputhje me rregulloret dhe kriteret përkatëse të UEFA-s dhe FFK-së.

Tarifa totale e pjesëmarrjes në Kursin UEFA Pro Licence është 7 500 euro për kandidat. Trajnerët e interesuar duhet të aplikojnë online përmes faqes zyrtare të Federatës së Futbollit të Kosovës dhe të dorëzojnë të gjithë dokumentacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar në këtë konkurs. Afati i fundit për aplikim është 20 shtator 2026. Aplikimet e pakompletuara ose të dorëzuara pas afatit mund të mos merren në shqyrtim.

Crystal Palace interesohet për Zhegrovën

Torino, 10 gusht - Crystal Palace është skuadra e fundit që ka shprehur interesim për shërbimet e Edon Zhegrovës, kur kanë mbetur edhe tri javë deri në fund të afatit kalimtar të verës. Është raportuar në medie se skuadra nga Premier League

ka kontaktuar Juventusin dhe mbetet të shihet se çfarë zhvillimesh do të ketë gjatë kësaj jave. Te Juventusin janë të gatshëm ta shesin Zhegrovën, i cili po insiston të qëndrojë në Torino për ta dëshmuar veten gjatë sezonit 2026/27. Trajneri

Luciano Spalletti ende nuk ka marrë një vendim të prerë për të ardhmen e Zhegrovës, ndonëse javën e kaluar pati lëvdata për paraqitjen e tij dhe golin e shënuar në fitoren ndaj Chelseat. Krahës Crystal Palace, situatën e Zhegrovës te

Juventusin po e monitorojnë edhe Evertoni, Fiorentina dhe disa skuadra nga Franca. Sulmuesi i krahut iu bashkua Juventusit verën e kaluar nga Lille për 15 milionë euro dhe ka kontratë me klubin italian deri në vitin 2030.



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Mix Shop Jara” Sh.P.K. me seli në Vushtrri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 812343309 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Mix Shop Jara” D.O.O. od Vushtrria, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812343309 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “FLEMINGO KOSOVO” L.L.C. with headquarters Vushtrri, has come to the decision to quit its business: 812343309 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Power Your German” Sh.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 812360767 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Power Your German” D.O.O. od Prishtina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812360767 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Power Your German” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 812360767 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Qamil Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti” në Mazdrek.

- Valmir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti” në Mazdrek.

- Elton Halili shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 11 të shkollës së mesme të lartë të mjekësisë “Dr. Xheladin Deda”.

- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.

- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m.”Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjiminazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjiminazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, pent-house. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

